



“Nevoja ime, vendimi im”




Përkrahur nga:



Abstrakt

Projekti “Nevoja ime, vendimi im” implementuar nga Organizata Joqeveritare Community Building Mitrovica (CBM), përkrahur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur KFOS, ka përfshirë katër komuna të regjionit verior të Kosovës: Mitrovicën veriore, Zubin Potokun, Zveçanin dhe Leposaviqin. Fokusi i projektit është në identifikimin e nevojave dhe prioriteteve të fshatrave gjeëgjëse, sic janë: Mitrovicë veriore: Fshatrat - Suhodoll, Gushavc, Vinarc i Poshtëm dhe i Epërm dhe Vidimriq; Zubin Potok: Fshati Çabër; Zvecan: Fshatrat – Boletin, Zhazhë dhe Lipë; Leposaviq Fshatrat - Bistricë, Cerajë dhe Koshtovë.



© Të drejtat autoriale

Asnjë pjesë nga ky publikim nuk mund të riprodhohet apo të ndryshohet pa lejen e botuesit. Mendimet e shprehura me shkrim apo në publikimet elektronike janë të Community Building Mitrovica (CBM) dhe nuk përfaqësojnë domosdo pikëpamjet e donatorit.

PËRMBAJTJA

1. HYRJE

1.1 Përshkrimi i organizatës.....	5
1.2 Përshkrimi i projektit.....	5
1.3 Metodologjia.....	5

2. ANALIZË E SITUATËS.....6

3. TË GJETURAT NË FSHATRAT E MITROVICËS VERIORE.....7

3.1 Projektet e planifikuara nga Komuna e Mitrovicës.....	10
3.2 Projektet e (pa) realizuara nga Komuna e Mitrovicës.....	10
3.3 Rekomandimet.....	11

4. TË GJETURAT NË FSHATIN E KOMUNËS SË ZUBIN POTOK-ut.....11

4.1 Projektet e planifikuara.....	12
4.2 Rekomandimet.....	12

5. TË GJETURAT NË FSHATRAT E KOMUNËS SË ZVEÇANIT13

5.1 Projektet e planifikuara	15
5.2 Rekomandimet.....	16

6. TË GJETURAT NË FSHATRAT E KOMUNËS SË LEPOSAVIQIT.....17

6.1 Projektet e planifikuara.....	18
6.2 Rekomandimet.....	19

7. KONKLUZIONI.....19

8. BURIMET.....20

SHKURTESAT:

CBM - Community Building Mitrovica

KFOS – Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur

MAPL – Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MMT – Mitrovica Monitoring Team

OJQ – Organizatë joqeveritare

PK – Policia e Kosovës

Përshkrimi i shkurtër organizatës Community Building Mitrovica:

Vizioni i CBM-së: Mitrovica një vend i sigurtë ku institucionet e përgjegjshme dhe shoqëria civile e fuqishme bashkëpunojnë në zhvillimin e një shoqërie demokratike ku çmohet diversiteti dhe mundësia e zgjedhjes së qytetarit.

Misioni i CBM-së: Organizatë lokale që identifikon dhe avancojnë interesat e përbashkëta të qytetarëve për integrimin e komuniteteve përmes facilitimit të dialogut ndëretnik dhe avokimit si dhe fuqizimin e shoqërisë civile karshi institucioneve llogaridhënëse.

Përshkrimi i projektit “Nevoja ime, vendimi im”

Projekti “Nevoja ime, vendimi im” synon që distancën mes qytetarëve shqiptarë të veriut dhe institucioneve përkatëse ta minimizoj sa më shumë që është e mundur. Duke përfshirë tri komunat të regjionit verior të Kosovës: Zubin Potokun, Zveçanin dhe Leposaviqin si dhe pjesën veriore të komunës së Mitrovicës, projekti synon që përveç përfaqësimit të qytetarëve në vendimmarrje dhe kanalizimin e politikave në koherencë me nevojat, të zvogëlojë amullin se cila komunë/institucion ka përgjegjësi ndaj kësaj pjese të shoqërisë.

Shtrirja hapsinore e projektit:

- Mitrovicë veriore: Fshatrat - Suhodoll, Gushavc, Vinarc i Poshtëm/Epërm dhe Vidimriq
- Zubin Potok: Fshati Çaber
- Zveçan: Fshatrat – Boletin, Zhazhë dhe Lipë
- Leposaviq: Fshatrat - Bistricë, Cerajë dhe Koshtovë

Metodologjia

Ky raport vlerësues bazohet në strategjinë e hulumtimit kualitativ. Sa i përket metodës, janë shfrytëzuar disa teknika. Më kryesore janë intervistat e bëra me zyrtarë dhe qytetarë të përfshirë në proceset përkatëse, si në nivel qendror, poashtu edhe atë lokal. Debatet e organizuara në katër regjionet e lartëcekura poashtu kanë shërbyer si indikator për të matur efektshmërinë e një projekti të zbatuar, dhe për të diktuar informimin e qytetarëve rreth projekteve zhvillimore dhe përgjegjësi që institucionet gjegjëse bartin në këtë proces. Pjesë e metodës ka qenë edhe monitorimi i Asamblesë Komonale të Komunës së Mitrovicës, për të parë nga afër se, sa ky institucion diskuton për këto fshatra. Indikator vlerësimi do të jenë përmbushja e një veprimi të caktuar, si dhe koha e përmbushjes.

ANALIZË E SITUATËS

Situata politike e veriut të vendit, që nga paslufta e tutje, e intensifikur pas shpalljes së pavarësisë, ka ndikuar që qytetarët shqiptarë të veriut, përveç frikës nga rreziqet dhe kërcënimet e shumëta, të ndjejnë dhe mospërkatësi, në kuptimin e qasjes në institucionet lokale. Me decentralizimin dhe krijimin e komunave të reja ky konfuzitet është shtuar edhe me shumë. Bërja e politikave dhe implementimi i tyre ka rezultuar shpesh jo i efektshëm, si pasojë e mospërfshirjes së qytetareve në vendimmarrje nga ana e vendimmarrësve institucional. Politikat karshi regjioneve të caktuara të vendit janë përgatitur e realizuar në mënyrë 'ad hoc', dhe njëherish vendime të caktuara dhe realizime projektsh janë ndërmarrë pa ditur paraprakishtë nevojat e qytetarëve;

- Qytetarët shqiptarë të veriut nuk dijnë cilës komunë t'i drejtohen/cili institucion është përgjegjës për të përmbushur nevojat e tyre;
- Përgjegjësitë dhe kompetencat e komunave veriore janë të paqarta, karshi qytetarëve shqiptarë që jetojnë në pjesën veriore;
- Projektet e realizuara shpeshherë nuk kanë qenë në koherencë me nevojat bazike që qytetarët e fshatrave veriore kanë;
- Qytetarët e veriut, në fshatrat e banuara me shqiptarë përveç izolimit që përjetojnë çdo ditë, ata janë aq shumë të lënë jashtë çdo procesi, sa që dhe ekzistenca e tyre shpesh vihet në pikëpyetje. Barrierat e krijuara tashmë, kanë ndikuar që kontakti i tyre me institucionet lokale të jetë shumë i rrallë, të mos themi se ky kontakt nuk ekzistonë fare.

Organet me të fuqishme të institucioneve të Kosovës në veri janë Zyrat Komunale për Komunitete, të cilat udhëhiqen nga shqiptarët dhe funksionojnë jashtë objekteve komunale. Ndonëse këto zyra janë të parapara vetëm për të promovuar të drejtat e komuniteteve jo shumicë, ato ushtrojnë edhe funksione të dhënies së dokumentacionit civil si dhe kryerjen e shërbimeve të tjera komunale.¹ Zyrat Lokale për Komunitete janë themeluar sipas rregulloreve të UNMIK-ut mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale në Kosovë, në fillim të vitit 2001 në Leposaviq dhe Zubin Potok dhe në qershor të vitit 2002 në Zveçan.² Zyra Komunale për Komunitete për Komunën e Leposaviqit është në fshatin Bistricë, ajo për Komunën e Zubin Potokut është në fshatin Çabër, kurse ajo për Komunën e Zveçanit është në fshatin Lipë.

¹ Letërnjoftimi i Komunës së Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit http://ëëë.institutigap.org/documents/34188_Leternjoftimiperkomunatveriore.pdf, Janar, 2013

² Rregullorja për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim. Burimi:

http://ëëë.kryeministriks.net/repository/docs/Rregullore_per_Zyrat_komunale_per_Komunitete_dhe_Kthim.


Pdf.

TË GJETURAT NË FSHATRA E MITROVICËS VERIORE

Debati i organizuar në shkollën “Harun Beka” të fshatit Gushavc është mirëpritur jashtëzakonisht mirë nga qytetarët e fshatrave të veriut të Mitrovicës. Ndër të tjera, u veçua se e vetmja rrugëdalje, dhe i vetmi komunikim që u ka mbetur këtyre qytetarëve me autoritetet lokale, është nëpërmjet shoqërisë civile, ngase deri sot janë shfrytëzuar të gjitha rrugët zyrtare por që rezultati ka qenë shumë minimal ose i padukshëm.³ Kryetari i fshatit Gushavc, z. Avdi Hajdari me prova materiale paraqiti kërkesat që u janë drejtuar Komunës së Mitrovicës, përkatësisht Kryetarit z. Avni Kastrati, duke filluar nga viti 2009 e tutje.⁴ Ndër nevojat kryesore, që ishin të shkruara në atë kërkesë, e që edhe sot mbeten po të njëjta janë:

- Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit;
- Rregullimi i rrjetit të kanalizimit;
- Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës nga xhamia e fshatit e lartë;
- Ndërrimi i rrjetit elektrik, (për më shumë se 40 vite asnjëherë nuk është riparuar);
- Përfundimi i zyrës vendore në fshatin Gushavc;
- Rindërtimi i shkollës fillore “Harun Beka”;
- Paisja e fshatit me kontenjerë për hudhje të mbeturinave;
- Investime në bujqësi dhe rritje e numrit të të punësuarëve;

Ndonëse tri projektet e para janë paraparë më buxhetin e vitit 2012, ky fshat ende nuk i gëzon këto të mira. Madje, dhe rrugës mund të vëresh se sa shumë këta qytetarë kanë nevojë për to. Ashtu siq u shpreh edhe një qytetarë i këtij fshati “është shumë e dhimbshme të shohësh në këtë kohë qytetarët e një fshati jo më larg se 4 km nga qendra e qytetit të furnizohen me ujë nga Ibri duke mbushur e bartur rezervuare që nuk plotësojnë kurrfarë kushti higjienik. Të shohësh fëmijë në dimër, me këpucë mbushur llac e borë duke ecur në një rrugë shumë të shkatërruar. Duke nuhatur erë kanalizimi në çdo cep të fshatit, fëmijët tanë janë në rrezik të infektohen edhe nga sëmundjet më të rënda, dhe kjo për arsye se kanalizimi ende nuk



³ Debati i mbajtur më 24 Gusht në shkollën fillore “Harun Beka” në Gushavc

⁴ <http://m-magazine.org/sq/Kosove/Shoqria-civile-e-vetmja-ur-lidhse-mes-qytetarve-dhe-autoriteteve-komunale-3021>

është përfunduar. Për të gjitha këto Kryetari i Komunës është i njoftuar, por asnjë aktivitet për përmirësim nuk është ndërmarrë ende”⁵.

Sa i përketë debatit të organizuar nga Komuna në Korrik të 2012-ës për “planifikim të buxhetit 2013”, qytetarët u shprehën shumë skeptikë, ndër të tjera ata përmendën faktin e jo informimit të duhur dhe gjithashtu neglizhencën e zyrtarëve të pranishëm në atë takim. Pothuajse në asnjë pyetje të parashtruar, zyrtarët nuk përgjigjeshin drejtë ose nuk i dinin informatat e duhura, prandaj konsiderohet që ai takim ka shkuar huq sikurse dhe kërkesat që u janë drejtuar Komunës së Mitrovicës gjerë më sot. Banorët e këtij fshati marrin pjesë edhe në debatet publike organizuar nga Kryetari i Komunës, dhe në të shprehin nevojat dhe kërkesat e veta, por që edhe aty ndjehen të anashkaluar.⁶

Po të njëjtit qytetarë shprehën keqardhje dhe ankesë për këshilltarët e Asamblesë Komunale z.Eset Ujkani dhe z.Ferit Jashari të dy banorë të fshatit Vinarc, të cilët janë zgjedhur nga ky lokalitet por që deri sot nuk kanë ngritur zërin për të ndikuar në politikat lokale karshi këtij regjioni të Mitrovicës.



Në vazhden e projektit, në Konferencën publike organizuar në fund të muajit Maj, në të cilën ishin pjesëmarrës qytetarë nga regjionet e targetuara, të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Kuvendit Komunal të Mitrovicës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) si dhe Policia e Kosovës (PK). Nga përfaqësuesi i Komunës, u arsyetua vonesa e përfundimit të projekteve gjegjëse, sic janë, rrjeti i ujësjellësit, kanalizimi,

⁵ Amet Beka, banor i fshatit Gushavc, debat mbajtur nga CBM me 24 Gusht 2012

⁶ Skënder Sahiti përfaqësues i fshatit Gushavc ka paraqitur kërkesën për problemin e ujit në fshatrat Gushavc, Vinarc, Vidimriq. Poashtu ndërtimin e shkollës në Gushavc, rindërtimin e rrugës Suhodoll-Vinarc si dhe problemin e rrjetit elektrik. Takimi i tretë publik i Kryetarit të Komunës me qytetarë, 21.03.2013

ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës, si dhe renovimi i shkollës së fshatit, mungesa e fondeve si gjithëherë është kryefjala e arsytimit për dështimet e Komunës.⁷

Ndër pakënaqësitë e banorëve të këtyre fshatrave është theksuar edhe jopërfshirja e tyre në kuadër të Fondit për Veriun, “Asnjë tull nuk është blerë nga fondi i veriut për këtë pjesë, dhe asnjë metelik nuk është hargjuar po nga ky fond për banorët e kësaj ane”.⁸ Gjithashtu, dhe përfshirja e kësaj pjese me stacionin policor të veriut (perderisa keto fshatra janë nën autoritetin e Komunës së Mitrovicës – jug), po shkakton problem dhe telashe për banorët. Policia e Kosovës arsyeton këtë fakt me strukturën organizative që tashmë është formësuar në këtë institucion e cila është trashëguar nga UNMIK-u.⁹

Të gjeturat kryesore:

- Adresimi i çështjeve tek autoritetet përkatëse mbetet ende problem;
- Asnjë metelik nga mjetet e ndara për “Fondi i Veriut” nuk është investuar në këtë pjesë;
- Për problemet e sigurisë përgjegjës është Stacioni Verior i Policisë së Kosovës, dhe për këto fshatra shqiptare kjo gjë shkakton telashe;
- Investimet e bëra nga Komuna e Mitrovicës janë të stërzgjatura, psh;
 - Rruga është shtruar me zhavor ndërsa për shkak të rrëshqitjes rruga është bllokuar;
 - Tani duhen mjete shtesë për të rregulluar rrugën;
 - Vendosja e betonit anës rrugës është bërë në dimër dhe tani me është dëmtuar;
 - Nuk ka mbikëqyrje të punimeve;
 - Rrjeti i kanalizimit ende nuk ka përfunduar;
 - Ujësjellësi ndonëse është përfunduar, ende ky fshat nuk ka ujë për pije;
- Shkolla “Harun Beka” në Gushavc është ndërtuar në vitin 1948 dhe që nga atëherë ka pasur vetëm renovime të vogla nga donator të huaj;
 - Ka vetëm katër klasë dhe 330 nxënës që për shkak të kushteve të këqija të shkollës kanë filluar të largohen;
 - Shkolla duhet të rindërtohet, sepse renovimet janë të kota;
- Mungesa e subvencioneve nga Qeveria thellon varfërinë në këtë pjesë;
- Papunësia dhe migrimi i banorëve problematikë e vazhdueshme;
- Zyra ndërlidhëse e cila është ndërtuar në Suhodoll është ende jofunksionale;
- Komuna e Mitrovicës vjen me projekte të gatshme pa diskutime paraprake;

⁷ Enes Jakoviq, përfaqësues i Komunës së Mitrovicës, zyrtarë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturë, Konferenca Publike “Nevoja ime, vendimi im”, 31 Maj 2013.

⁸ Fatmir Zeka, Përfaqësues i fshatit Gushavc, Konferenca Publike “Nevoja ime, vendimi im”, 31 Maj 2013

⁹ Avni Zahiti – Policia e Kosovës, Konferenca Publike “Nevoja ime, vendimi im”, 31 Maj 2013

Projektet e planifikuara nga Komuna e Mitrovicës

Në buxhetin e Rishikuar të Financimit Vjetor të investimeve kapitale komunale për vitin 2012 është planifikuar të realizohen këto projekte gjatë vitit kalendarik për Fshatrat e veriut të Mitrovicës (Gushavc, Vinarc, Vidimriq, Suhodoll) :

Emri i Projekti	2012	Kostoja Rishikuar	Financimi i Jashtëm
Ndertimi dhe asfaltimi i rruges ne fshatin Gushavc	20 000 €	30 000 €	00 €
Ndertimi i rrjetit te ujësjellsit ne fshatin Vidimriq	00 €	21 589 €	00 €
Ndertimi i zyres vendore ne Shuplovç dhe Suhodoll	52 630 €	52 630 €	00 €
Instalimi i kamerave ne Shfmu''Harun Beka''	3000 €	3000 €	00 €
Renovimi i brendshem ne Shfmu ''Harun Beka''	5500 €	5500 €	00 €

Projektet e (pa) realizuara nga Komuna e Mitrovicës

1. Ndertimi dhe asfaltimi i rruges ne fshatin Gushavc – Nuk është realizuar;
2. Ndertimi i rrjetit te ujësjellsit ne fshatin Vidimriq - Pjesërisht është realizuar (ende nuk ka ujë);
3. Ndertimi i zyres vendore ne Suhodoll - ende jo-funksionale;
4. Instalimi i kamerave ne Shfmu''Harun Beka'' -nuk është realizuar;
5. Renovimi i brendshem ne Shfmu ''Harun Beka'' - nuk është realizuar;

Rekomandimet

- Të instalohet një komunikim formal në intervale të rregullta kohore mes qytetarëve të kësaj ane dhe Komunës së Mitrovicës;
- Kërkesat e drejtuara në Komunën e Mitrovicës të mirren parasysh dhe të inkorporohen në planifikimin e buxhetit komunal;
- Të investohet në këtë pjesë, e cila praktikisht është në veri, kurse teoritikisht në jug;
- Të bëhet informimi i rregulltë dhe i duhur për debatet publike organizuar nga Komuna e Mitrovicës
- Zyra Vendore duhet të fillojë punën sa më parë;
- Në Zyrën Vendore duhet të punësohen fshatarët e këtij regjioni;

TË GJETURAT NË FSHATRA TË KOMUNËS SË ZUBIN POTOK-ut

Për dallim nga fshatrat shqiptare të komunave tjera të targetuara, fshati Cabër gëzon kushte më të mira jetësore. Infrastrukturë të mirë rrugore, ndriqim, kanalizim dhe



ujësjellësi janë funksional, megjithëse ende vërehet nevoja për përmirësime të mëtutjeshme. Si gjithmonë, sfidë kryesore për banorët e fshatit mbetet cenimi i lëvizjes së lirë nga vendosja e barrikadave të shpeshta në rrugën kryesore në Zubin Potok, e në këtë aspekt, çështja e sigurisë mbetet ende delikate dhe e brishtë.

Blokimet e rrugëve ka ndikuar edhe në mbarëvajtjen e projektit “Nevoja ime, vendimi im”. Shpeshherë janë shfrytëzuar rrugë alternative për të ardhur deri tek informacioni apo për të parë gjendjen në të cilën këta qytetarë jetojnë dhe veprojnë¹⁰. Ekipi nga CBM-i ka arritur të vëjë kontakt me zyrtarin për Komunitete në fshatin Cabër, i cili u mundua të sqarojë drojtjen e qytetarëve për të marrë pjesë në debat. Gjithashtu në diskutim u sipër u përmendën dhe projektet që Qeveria e Kosovës ka planifikur t'i realizojë në fshatin Cabër.¹¹ Ndonëse qytetarët e pranishëm u shprehën se ky fshat ka nevojë të mëdha, por mbi të gjitha këto projekte janë të nevojshme, megjithatë projekti i ujësjellsit është shumë urgjent. Gjatë 24 orëve ky fshat ka ujë të pijshëm vetëm një orë në mëngjes dhe një orë në mbrëmje.

Të gjeturat kryesore:

- Siguria e banorëve të Cabrës është ende e brishtë;
 - o Blokimet e rrugës kryesore cënon lëvizjen e lirë;
 - o Rrugët alternative shpeshherë janë të pakalueshme;
- Fshati ka mungesë të ujit të pijshëm, ujë ka vetëm një orë në mbrëmje dhe një orë në mëngjes;

¹⁰ Blokimet e rrugës në Zupç shkakton anulimin e debatit me qytetarë, http://ëëë.cbmitrovica.org/index.php?option=com_content&task=view&id=148&Itemid=36&lang=albanian, 24 Gusht 2013

¹¹ UJË TË PIJSHËM VETËM NJË ORË NË MËNGJES DHE NJË ORË NË MBREMJE!, [HTTP://M-MAGAZINE.ORG/SQ/KOSOVE/UI-T-PIJSHM-VETM-NI-OR-N-MENGJES-DHE-NI-OR-N-MBREMJE-3006](http://M-MAGAZINE.ORG/SQ/KOSOVE/UI-T-PIJSHM-VETM-NI-OR-N-MENGJES-DHE-NI-OR-N-MBREMJE-3006), 24 GUSHT 2012

- Debatet publike me banorët e fshatit mungojnë shume, megjithëse janë shumë të nevojshëm;

Projektet e planifikuara

Emri i Projekti	2012	Kostoja Rishikuar	Financimi i Jashtem
Nderitimi i Qendres se Kultures	350 000 €	350 000 €	00 €
Blerja e automjetit zyrtar	40 000 €	40 000 €	00 €
Rregullimi i Ujesjellsit	152 238 €	152 238 €	00 €
Meremetimi i QKMF	125 394 €	125 394 €	00 €
Blerja e dy automjeteve	60 000 €	60 000 €	00 €

Rekomandimet

- Duhet të garantohet siguri 24 ore për banorët e fshatit Cabër;
- Të rregullohen rrugët alternative;
- Të punohet me shumë që të mos lejohet vendosja e barrikadave dhe bllokimi i rrugëve;
- Uji i pijshëm duhet të jetë në dispozicion për banorët e fshatit;
- Të mbahen debate publike te rregullta dhe periodike, si dhe qytetarët të njoftohen rregullisht për këto debate;
- Zyra e Komuniteteve në këtë fshat të bëjë raportim periodik të fshatarët për projektet e planifikuara dhe të (pa) realizuara;

TË GJETURAT NË FSHATRA E KOMUNËS SË ZVEÇANIT

Në debatin publik organizuar nga CBM në dhjetor te vitit 2013 me banorët e fshatrave Kelmend, Zhazhë dhe Boletin të komunës së Zveqanit, dolën rezultate të shumta sesi këta qytetarë ballafaqohen më probleme të shumta në përditshmërinë e tyre. Banorët e këtyre tri fshatrave të cilët ishin prezent janë shprehur mirënjohës për organizimin e këtij debati që sipas tyre ishte i pari i këtij lloji ku ata do të kishin mundësi për të shprehur idetë, paknaqësitë dhe rishikimin e mundësive për përmisimin e kushteve të

jetës së tyre. Si dhe në pjesët tjera, edhe në këto fshatra sigura e brishtë dhe cënimi i lëvizjës së lirë mbesin brengat kryesore të banorëve. Banorët e fshatarave Boletin, Zhazhë e Kelmend kanë shprehur hapur pakënaqsinë e tyre me mos mbështetjen, përkatsisht me investimet që janë bërë deri më tani në ato lokalitete¹².



Të pranishmit janë shprehur të pakënaqur me investimet që janë bërë deri më tani, në veqanti në fshatrat Boletin e Zhazhë. Mungesa e ujit të pijës, mungesa e rrymës elektrike, sigurimi i transportit publik, papunësia, mos përfaqësimi i duhur i problemeve në instance më të larta, mungesa e takimeve me udhëheqës lokal ishin disa nga çështjet që banorët i shprehën si brengë të tyre. Banorët nuk janë aspak të kënaqur me punët të cilat janë zhvilluar në punimet e rrugës lokale tek Maksutovit dhe Sejdiqovit. Sipas tyre punët nuk janë kryer si duhet, "Është e tmerrshme ngase shuma prej 57 906 eurove veq sa e ka dëmtuar buxhetin e Kosovës, dhe nuk ka lehtësuar problemet e banorëve sepse nuk është berë zgjidhje e problemeve. Dy rrugët të cilat sillen rreth 500 metra janë shtruar vetëm me një shtresë të hollë zhavori, nuk është bërë zgjerimi i rrugës si dhe nuk është bërë zgjidhje e problemit të kanalazimit "¹³.

Ferit Peci, poashtu nga fshati Zhazhë ka shfaqur problemin e vazhdueshëm të ujit të pijshëm, për fshatin Boletin e Zhazhë "Janë dhënë mjete për të zgjedhur problemin e ujit të pijshëm, për ngritjen e kapacitetit të bazenit akumulues, po ky problem u zgjedh veq për fshatin Lipë, e ne dy fshatrat vazhdojnë të ballafaqohen ende me mungesë të ujit të pijës". Gjithashtu, është theksuar se banorët e fshatarave Boletin e Zhazhë asnjëhere nuk janë thirrur, informuar apo vizituar ndonjëherë nga udhëheqësit lokal për të shikuar dhe për të bërë zgjidhjen e problemeve të tyre "Këto dy fshatra të komunës së Zveqanit janë të harruara nga shteti, sepse me shku në Mitrovicë thonë nuk jeni me komunën tonë, zyra në Lipë, nuk bënë zgjidhje dhe nuk duan me u taku me neve, veq me u ba shpiun i Zveqanit e nashta na ndihmojnë e e marrim naj rrogë" ka thënë i moshuari Peci i cili ndër të tjera ka potencuar faktin se në këto fshatra poashtu ka ende shtëpi të cilat

¹² Boletinasit, Zhazhianët dhe Kelmendasit ankohen për anashkalim, http://mitrovicatoppress.com/index.php?option=com_content&view=article&id=969:banoret-e-fshatrave-boletin-zhazhe-dhe-kelmend-te-komunes-se-zveqanit-ankohen-se-jane-anashkaluar-&catid=54:reportazhe&Itemid=75, 21 Janar 2013

¹³ Abit Peci nga fshati Zhazhë, debat publik me banorët organizuar nga CBM, 15.12.2013

janë shkatërruar gjatë vitit 1999 dhe nuk janë rindërtuar plotësisht.¹⁴ Megjithëse në takimin e datës 30.10.2012 të Asamblesë Komunale u cek nga kryetari Kastrati se ka mbaruar procesi i aksionit për ndërtimin e pronave të banorëve shqiptar të veriut. Konto është mbyllur, dhe se të gjithë familjet me kushte të rënda ekonomike do të jenë prioritet për ndërtimin e shtëpive në veri të Mitrovicës. Është aprovuar plan programi për rindërtim të shtëpive në veri të Mitrovicës, në Zubin Potok (Cabër), Leposaviq dhe Zvecan.

Ndërsa, përfaqësuesi i banorëve të fshatit Boletin, Xhevat Peci ka potencuar se edhe pse ata janë në komunën e Zveqanit ata nuk përfaqësohen dhe nuk kontaktohen nga zyrtarë të kësaj komune. Ai ka thënë se përveq drejtorit të zyrës së komuniteteve në Kelmend i cili ka kontakte me zyrtarë të komunës së Zveqanit, askush nuk ka e që sipas tij problemet e banorëve Boletin e Zhazhë vazhdojnë të mbesin të pazgjidhura. Ai ka potencuar se ka probleme dhe pengesa të cilat po i shfaq Manastiri” Sokolica” që sipas tij vazhdimisht ka tendeca të zgjerimit të hapsirave dhe po tenton të mbyll edhe shkollën fillore të fshatit. “Manastiri ka sjell edhe njerëz të armatosur në malet përreth tij, e që është shqetësuese për banorët” ka thënë ai para bashkë fshatarëve të tij. Një banor tjetër poashtu nga Boletini, Kamer Peci kritikuar e tij i ka drejtuar tek zyrtarët e zyrës për komunitete në Kelmend. Sipas tij të gjitha investimet po bëhen po në këtë fshat ngase drejtori është banor i këtij fshati. Ai ka kritikuar organet udhëheqëse poashtu në mos zgjidhjen e transportit publik që sipas tij banorët e këtyre fshatrave do duhej të e kishin falas. Ndërsa përfaqësuesi i banorëve të fshatit Zhazhë ka thënë se në mënyrë të zgjidhjes së problemve të fshatarve Boletin e Zhazhë ka kërkuar disa herë nga drejtori i Zyrës për komunitete në Kelmend të takohet me banorët e fshatrave Boletin e Zhazhë, por ai vazhdimisht nuk ka pranuar.

Zyrtari i MAPL-së, të pyetur direkt nga banorët lidhur me kompetencat e Zyrës për Komunitete, si dhe projektet që këto institucione kanë (jo) realizuar, është përgjigjur se, cdo qytetarë, sikurse dhe këta banorë të këtyre fshatrave janë të hapur të drejtojnë kërkesë/ankesë direkt në MAPL, dhe ministria është e obliguar që në një afat prej shtatë ditëve të u kthej përgjigje. Sa i përket Komunave veriore, përkatësisht fshatrave shqiptarë në këto komuna gjendja është më e komplikuar, strukturat serbe nuk pranojnë të bashkëpunojnë me institucionet e Republikës së Kosovës, përderisa fshatarët janë lënë plotësisht anash.

Të gjeturat kryesore:

- Siguria e banorëve të këtyre tri fshatrave është ende e brishtë;
 - o Bllokimi i rrugës kryesore cenon lëvizjen e lirë;
 - o Rrugët alternative shpeshëherë janë të pakalueshme;

¹⁴ Shahin Peci banor nga Boletini, debat publik me banorët organizuar nga CBM, 15.12.2013

- Popullata e këtyre fshtrave ka migruar për qytet përshkakë të kushteve të rënda të jetesës;
 - Ka nevojë të madhe për ndërtim dhe rindërtim të shtëpive në këto fshatra;
- Ka mungesa e ujit të pijshëm ;
- Udhëtimi i popullatës është duke u bërë me pagesë;
 - Ka nevojë të madhe për transportim të nxënësve të fshatit për në shkollën fillore në Boletin (mbi 6km);
- Rrjeti elektrik është jashtëzakonisht shumë i dëmtuar;
- Nuk bëhet përfaqësimi i duhur i problemeve në instance më të larta,
- Dy rrugët Maksutovit dhe Sejdiqovit të cilat sillen rreth 500 metra janë shtruar vetëm me një shtresë të hollë zhavori, nuk është bërë zgjerimi i rrugës si dhe nuk është bërë zgjidhje e problemit të kanalazimit;

Projektet e planifikuara¹⁵

646000 - Zveçan							
646195 - Zyra e Komuniteteve							
196300 - ZLK - Zveçan							
	646195-1215770	86471	Ndërtimi i rrugeve lokale Boletin i Ulët - Zhazhë	485,000	0	0	485,000
	646195-1215790	86472	Ndërtimi i rrugeve lokale tek lagjet Maksutovit dhe Sejdiqovit	57,906	0	0	57,906
	646195-1216347	86473	Ndërtimi i dy trafostacioneve shtes dhe linjes së tensionit të	70,000	0	0	70,000
	646195-1216348	86474	Renovimi i rrugeve Lipe - Rudar	20,000	0	0	20,000
	646195-1216349	86207	Punimi i fushës sportive në fshatin Lipe me shtresë Tartani	50,000	0	0	50,000
	646195-1216350	86208	Mirëmbajtja e rrugeve Lipe-Boletin-Zhazhe	10,000	0	0	10,000
	646195-1216351	86475	Rindërtimi i dy Trafostacioneve në Lipe dhe Boletin	20,000	0	0	20,000
	646195-1216827		Asfaltimi i rrugeve lokale Boletin i ulët-Zhazhe	0	712,906	0	712,906
	646195-1216830		Asfaltimi i rrugeve lokale Boletin i Eperme	0	0	90,000	90,000
	Totali - ZLK - Zveçan			712,906	712,906	90,000	1,515,812

Rekomandimet

- Duhet të garantohet siguri 24 orëshe për banorët e kësaj pjese;
- Të rregullohen rrugët alternative;
- Të punohet me shumë që të mos lejohet vendosja e barrikadave dhe bllokimi i rrugëve;
- Ka nevojë të madhe për ndërtim dhe rindërtim të shtëpive në këto fshatra;
- Këto fshatra duhet të kenë qasje në ujë të pijshëm ;
- Udhëtimi i popullatës duhet të bëhet pa pagesë;

¹⁵ Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Raporti vjetor i buxhetit 2012. Burimi: <http://mf.rks-gov.net/sql/ministriaefinancave/buxhetiirepublikesekosoves/buxhetiqtendrore.aspx>

- Ka nevojë të madhe për transportim të nxënësve të fshatit për në shkollën fillore ne Boletin (mbi 6km);
- Rrjeti elektrik duhet të riparohet;
- Të instalohet një organ i cili në mënyrë të rregull periodike do të bënte adresimin e nevojave dhe kërkesat tek instancat më të larta;
- Të rregullohet kanalizimi;
- Të bëhet ndërtimi i rrugëve dhe zgjerimi i rrugëve aktuale;
- Zyra e Komuniteteve të bëjë raportim periodik te fshatarët për projektet e planifikuara dhe të (pa) realizuara;

TË GJETURAT NË FSHATRA E KOMUNËS SË LEPOSAVIQIT

Banorët e fshatrave Bistricë, Cerajë dhe Koshtovë janë ndër qytetarët më të lënë anash nga institucionet jo vetëm ato lokale, por edhe nga ato qendrore. Këta qytetarë kalojnë ditët duke u ballafaquar me sfida të mëdha dhe pothuajse të patejkalueshme. Banorët e fshatrave të lartëpërmendura janë shprehur të pakënaqur me investimet dhe kujdesin që i'u është bërë deri më tani, qoftë nga institucionet lokale apo qendrore. Asfaltimi i rrugës ,sigurimi i transportit publik me orar më të shtuar, sigurimi i derivateve për transportin e nxënësve të tri fshatrave që vijojnë mësimet në shkollën fillore në Bistricë, pastaj sigurimi i transportit për nxënësit që vijojnë mësimet në shkollat e mesme dhe universitare në Mitrovicë¹⁶, mos përfaqësimi i duhur i problemeve në instance më të larta, rindërtimi i shtëpive, marrja e masave të mos shpërnguljes së banorëve,



funkcionimi i autoambulancës (sigurimi i derivateve) vizita më të shpeshta të mjekut në fshat, investime dhe përkrahje për rimëkëmbje të bujqësisë , aktivitete kulturore me të rinjtë, si dhe mungesa e takimeve me udhëheqës lokal ishin disa nga çështjet që banorët i shprehën si brengë të tyre.

Behxhet Hetemi banorë i fshatit Bistricë ka kritikuar udhëheqësit

lokal dhe të qeverisë së Kosovës që sipas tij nuk po merren me problemet elementare dhe se janë harruar nga të gjithë. “Ne ndihemi dhe jemi të harruar nga të gjithë, jetojmë

¹⁶ Faik Mustafa, mësimdhënës në Shkollën fillore “Kadri Bistrica”, Debat public organizuar nga CBM më 17 Janar 2013

në kushte shumë të vështira dhe të izoluar . Këto fshatra janë të diskriminuara në qdo aspekt. Nuk kemi as kujt të i drejtohem për problemet tona “ka thënë ai duke shtuar se ata si banor i dinë dhe i duan të drejtat e tyre por, dhe se askush nuk po merret me këto probleme elementare për jetë”. I riu nga fshati Kosohtovë, Blerim Bekteshi ka cekur si problem për të mungesën e qarkullimit ngase autobusi qarkullon vetëm tri herë në ditë. Ai tha për shkak të pamundësisë së punësimit në fshat, ata kërkojnë punë në Mitrovicë, por prapë mbesin pa punë ngase oraret e punës dhe të qarkullimit të autobusit nuk përshtaten. Shefki Musliu ka ngiutr qështjen e rindërtimin e shtëpive si primare për të.

Shaqir Hetemi banor i fshatit Bistricë si shqetësim të tij ka ngritur qështjen e sigurisë së lëvizjes së lirë. “Po bëhen 14 vite e ne vazhdojmë të lëvizim me përcjellje të Policisë së Kosovës”. Ndërsa, Lulzim Hetemi përfaqësues i banorëve të fshatit Bistricë si problem kryesor që do zgjidhtë dhe lehtësonte problemet e banorëve të këtyre fshatrave është shefi i Zyrës së Komuniteteve pranë Kuvendit Komunal të Leposaviqit që sipas tij nuk mirret me problemet e banorëve.¹⁷ Ai poashtu ka ofruar material në të cilat ai ka bërë një peticion me banorët e fshatit për largim nga detyra për Shefin e Zyrës së Komuniteteve. Gjithashtu, dhe mosintegrimi i Komunës së Leposaviqit në kuadër të Institucioneve dhe ligjeve të Republikës së Kosovës paraqetë problem serioz për banorët. Keto fshatra nuk kanë asnjëlloj bashkëpunimi më komunën.¹⁸ Ky dhe mund të jetë shkak për shpërnguljen e banorëve të kësaj pjese, ngase pamundësia e qasjes në strukturat lokale shkakton dhe problem të shumta që vështirësojnë jetesën në këto lokalitete.

Të gjeturat kryesore

- Siguria e banorëve e brishtë, dhe nuk ka lëvizje të lirë shkak i bllokimit të rrugëve;
- Rruga jo e asfaltuar;
- Transporti publik me orar shumë të rallë;
- Nxënësit që shkollohen në qytet nuk kanë transport të rregulltë;
- Banorët e kësaj pjesë po shpërngulen me të madhe;
- Ka shumë shtëpi të parindërtuara;
- Autoambulanca nuk funksionon në rregull, dhe mjeku bënë vizita shumë të rralla;
- Nuk ka investime në bujqësi;
- Nuk ka aktivitete kulturore sportive për të rinjtë;
- Ka mungesë të takimeve me udhëheqës lokal;

¹⁷ Lulzim Hetemi përfaqësues i banorëve të fshatit Bistricë, Konferencë publike organizuar nga CBM, 31 Maj 2013, Mitrovicë

¹⁸ Bajram Hetemi banor i fshatit Bistricë, debat publik organizuar nga CBM, 17 janar 2013, Bistricë

Projektet e planifikuara¹⁹

641195 - Zyra e Komuniteteve							
196050 - ZLK - Leposaviq							
	641195-1216845	85998	Asfaltimi i rrugës ne fshatin Koshtov, Bistric dhe Ceraç	662,000	224,021	224,021	1,110,042
	641195-1216850	85999	Asfaltimi i rruges ne Arvatska	224,021	300,000	300,000	824,021
	641195-1216854		Projekt per bashkfinancim	0	400,000	400,000	800,000
	641195-1216860	86000	Blerja e nje automjeti zyrtar	38,000	0	0	38,000
	Totali - ZLK - Leposaviq			924,021	924,021	924,021	2,772,063
	Totali - Zyra e Komuniteteve			924,021	924,021	924,021	2,772,063

Rekomandimet

- Duhet të garantohet siguri 24 orëshe për banorët e kësaj pjese;
- Asfaltimi i rrugës;
- Sigurimi i transportit publik me orar më të shtuar;
- Sigurimi i derivateve për transportin e nxënësve të tri fshatrave që vijojnë mësimet në shkollën fillore në Bistricë;
- Sigurimi i transportit për nxënësit që vijojnë mësimet në shkollat e mesme dhe universitare në Mitrovicë;
- Rindërtimi i shtëpive, marrja e masave të mos shpërnguljes së banorëve;
- Funksionimi i autoambulancës (sigurimi i derivateve), vizita më të shpeshta të mjekut në fshat;
- Investime dhe përkrahje për rimëkëmbje të bujqësisë ;
- Aktivitete kulturore me të rinjtë;
- Zyra e Komuniteteve të bëjë raportim periodik te fshatarët për projektet e planifikuara dhe të (pa) realizuara;

¹⁹ Projektet e planifikuara nga buxheti qëndrorë për Komunën e Leposaviqit për vitin 2012 / Zyra e Komuniteteve

KONKLUZION

Qytetarët shqiptarë të veriut sfidë primare e shohin sigurinë e brishtë dhe cenimin e lirisë së lëvizjes. Ata kanë vështirësi dhe telashe të shumta në adresimin e problemeve të tyre, duke u anashkaluar nga komunat gjegjëse si dhe nga institucionet qendrore. Qytetarët shqiptarë të veriut nuk dijnë cilës komunë t'i drejtohen/cili institucion është përgjegjës për të përmbushur nevojat e tyre.

Qytetarët e veriut, në fshatrat e banuara me shqiptarë përveç izolimit që përjetojnë çdo ditë, ata janë aq shumë të lënë jashtë çdo procesi, sa që dhe ekzistenca e tyre shpesh vihet në pikëpyetje. Barrierat e krijuara tashmë, kanë ndikuar që kontakti i tyre me institucionet lokale të jetë shumë i rrallë, të mos themi se ky kontakt nuk ekzistonë fare. Nevoja është shumë e madhe për projekte zhvillimore dhe investime kapitale si dhe ka nevojë të madhe e përfshirjes së qytetareve në vendimmarrje e në këtë aspekt është e nevojshme të bëhet planifikim i duhur dhe në koherencë me nevojat .

Sa i përket nevojave të shtruara, pothuajse në çdo lokalitet, investimet në infrastrukturë zënë vendin primar, duke çenë të domosdoshmë për përmirësim të jetesës, si dhe rimëkëmbje të ekonomisë. Infrastruktura tejte e shkatërruar, është ndër arsyt kryesore që influencën banorët e këtyre pjesëve të shpërngulen. Kushtet e rënda ekonomike veçsa e vështirësojnë dhe më shumë gjendjen në të cilën ndodhen këta qytetarë. Prandaj, investimet në bujqësi, dhe punësimi, sidomos i të rinjve, janë parakusht për të ndalur këtë ndryshim/pakësim demografik që është duke ndodhur në veri të Republikës së Kosovës.

BURIMET:

1. M-Magazine, <http://m-magazine.org/sq/Kosove/-147Nevoja-ime-vendimi-im-148-2988>
2. Instituti GAP, Letërnjoftimi i Komunës së Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit
http://ëëë.institutigap.org/documents/34188_Leternjoftimiperkomunatveriore.pdf
3. Rregullorja për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim
4. http://ëëë.kryeministriks.net/repository/docs/Rregullore_per_Zyrat_komunale_per_Komunitete_dhe_Kthim. Pdf.
5. M-Magazine, <http://m-magazine.org/sq/Kosove/Shoqria-civile-e-vetmja-ur-lidhse-mes-qytetarve-dhe-autoriteteve-komunale-3021>
6. Bllokimi i rruges në Zupç shkakton anulimin e debatit me qytetarë,
http://ëëë.cbmitrovica.org/index.php?option=com_content&task=view&id=148&Itemid=36&lang=albanian
7. M-MAGAZINE, UJË TË PIJSHËM VETËM NJË ORË NË MENGJES DHE NJË ORË NË MBREMJE!, [HTTP://M-MAGAZINE.ORG/SQ/KOSOVE/UJ-T-PIJSHM-VETM-NJ-OR-N-MENGJES-DHE-NJ-OR-N-MBREMJE-3006](http://M-MAGAZINE.ORG/SQ/KOSOVE/UJ-T-PIJSHM-VETM-NJ-OR-N-MENGJES-DHE-NJ-OR-N-MBREMJE-3006),
8. Boletinasit, Zhazhianët dhe Kelmendasit ankohen për anashkalim,
http://mitrovicatoppress.com/index.php?option=com_content&view=article&id=969:banoret-e-fshatrave-boletin-zhazhe-dhe-kelmend-te-komunes-se-zveqanit-ankohen-se-jane-anashkaluar-&catid=54:reportazhe&Itemid=75
9. Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Raporti vjetor i buxhetit 2012.
<http://mf.rks-gov.net/sqal/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxheti-qendrore.aspx>

Debatet organizuar nga CBM:

10. Debati “Nevoja ime, vendimi im” në shkollën fillore “Harun Beka”, 24 gusht 2012 në Gushavc, Komuna e Mitrovicës
11. Debati “Nevoja ime, vendimi im” mbajtur më 15 Dhjetor 2013 në Boletin të komunës së Zveçanit.
12. Debati “Nevoja ime, vendimi im” në shkollën fillore “Kadri Bistrica”, më 17 Dhjetor 2013 në Bistricë, Komuna e Leposavicit
13. Konferenca finale “Nevoja ime, vendimi im”, 31 Maj 2013, Mitrovicë

Takimet e Komunës së Mitrovicës të monitoruara nga CBM

14. 12 Takime të Asamblesë Komunale, Qershor 2012 – Qershor 2013
15. 12 Takime të Komitetit për Politikë dhe financa, Qershor 2012 – Qershor 2013
16. 4 Takime të Kryetarit të Komunës me publikun
17. Takimet Konsultative për planifikimin e buxhetit 2013